

REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
DHOMA KOMBËTARE E NOTERISË  
DEGA VENDORE TIRANË  
NOTER MIMOZA XHAFAJ



V2024054080054356153

DATE 13/06/2024  
NR REP 699



VËRTETIM NËNSHKRIMI

Sot, në datë 13.06.2024 (*dymijë e njëzet e katër*), përpara meje Notere Mimoza XHAFAJ, Anëtare e Dhomës Kombëtare të Noterisë, Dega Vendore Tiranë, me Zyrë në adresën: Rruga "Ibrahim RUGOVA", nr. 5, Pallatin Sky Tower, kati I-<sup>rë</sup>, Tiranë, u paraqitën personalisht Palët e interesuara si më poshtë:

**Z. Serxho BRAÇE**, shtetas shqiptar, i biri i Karafil dhe Marjeta, i ditëlindjes 19.10.1963, lindur në Tiranë dhe banues në Tiranë, në adresën: "Sheshi Jozef S Martin; Nd. Nd 3; H. H 10; Ap. Ap 15; Tirane; Njesia bashkiake Nr. 5; 1019; Tiranë", madhor dhe me zotësi të plotë juridike për të vepruar, për identitetin e të cilit u garantova me Letërnjoftimin ID Nr. 037072757 dhe me Nr. Personal G31019070R

**BAZA LIGJORE:** Ligji 110/2018 "Për Noterinë", neni 128 dhe neni 62, pika 1.

Të cilët, nënshkruan rregullisht para meje Noteres, me vullnetin e tyre të lirë dhe të plotë: "*Statuti i Shoqërisë "Serrez" shpk, nënshkruar në datë 12.06.2024*" hartuar jashtë kësaj zyre noteriale dhe unë Noteria në bazë të ligjit vërtetoj nënshkrimin e tyre sipas ligjit.

Unë, Noterja deklaroj se mora pëlqimin e Palëve për përdorimin e të dhënave personale. Këto të dhëna janë konfidenciale dhe u përdorën vetëm për krijimin dhe redaktimin e këtij Akti, në zbatim të Ligjit nr. 9887, datë 10.03.2008 "Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale", i ndryshuar.



NOTERE  
MIMOZA XHAFAJ

Mimoza Xhafa





Në përputhje me kërkesat e Ligjit nr. 9901, datë 14.04.2008 “Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare”, i ndryshuar, Themeluesit e Shoqërisë “Serrez”, më datën 12.06.2024 nxjerrin:

## STATUTIN

E

### “SERREZ” SH.P.K.

Shoqëri me përgjegjësi të kufizuar

Rruga Vangjel Çeço, Kompleksi i magazinave, Vaqarr, Kombinat, Tiranë

#### KREU I

#### EMRI, OBJEKTI, KOHËZGJATJA, ADRESA

##### Neni 1

#### Dispozitat e përgjithshme

1.1. Me këtë Statut rregullohen këto çështje:

- emërtimi i Shoqërisë;
- lloji i shoqërisë;
- adresa e selisë së saj;
- periudha e kohëzgjatjes;
- veprimtaria e shoqërisë;
- organet drejtuese;
- emrat dhe adresat e themeluesve; dhe
- procedurat me të cilat mund të ndryshohen rregulloret.

##### Neni 2

#### Emërtimi i shoqërisë me përgjegjësi të kufizuar

2.1. Sot, me datën 12.06.2024 (dymbëdhjetë qershor, dy mijë e njëzet e katër), themeluesi ka krijuar Shoqërinë Tregtare me emër ligjor “**SERREZ**”, shoqëri me përgjegjësi të kufizuar. Shkurtimisht: “**SERREZ**” sh.p.k., e cila këtu e më poshtë do të quhet Shoqëria.

2.2. Themeluesi i Shoqërisë është Serxho Braçe i biri i Karafilit dhe i Marjetës, lindur dhe banues në Tiranë, mbajtës i letërnjoftimit me nr. personal G31019070R, me ditëlindje 19.10.1963.

##### Neni 3

#### Forma dhe baza ligjore e Shoqërisë

3.1. Shoqëria Tregtare është sipas formës ligjore Shoqëri me Përgjegjësi të Kufizuar, shkurtimisht SH.P.K.

Faqja 1 nga 6

*Serxho Braçe*

*Braçe*



3.2. Shoqëria do të zhvillojë aktivitetin e saj në përputhje të plotë me këtë statut dhe dispozitat ligjore të legjislacionit të Republikës së Shqipërisë. Ajo e fiton personalitetin juridik pas regjistrimit në Qendrën Kombëtare të Biznesit.

3.3. Për sa nuk parashikohet në këtë statut, do të zbatohen dispozitat e ligjit “Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare”, Kodit Civil dhe çfarëdo lloji ligji tjetër specifik në Republikën e Shqipërisë.

#### Neni 4

#### **Adresa e Selisë**

4.1. Selia qendrorë e Shoqërisë është në adresën: Rruga Vangjel Çeço, Kompleksi i magazinave, Vaqarr, Kombinat, Tiranë.

4.2. Shoqëria mund të themelojë degë (filiale), zyra përfaqësimi brenda dhe jashtë vendit në pajtim me legjislacionin në fuqi.

#### Neni 5

#### **Periudha e kohëzgjatjes së Shoqërisë**

5.1. Kohëzgjatja e veprimtarisë së shoqërisë si sh.p.k. do të jetë në afat të pacaktuar, me përjashtim të rastit të mbarimit të saj sipas kushteve të parashikuara në ligj ose me vendim të ortakut të vetëm.

#### Neni 6

#### **Objekti i veprimtarisë së shoqërisë**

6.1. Objekti i veprimtarë së shoqërisë do të jetë:

**Prodhim dhe tregtim i proçeseve të veshjeve të këmbëve dhe konfeksioneve të ndryshme, import-eksport. Aktivitet në fushën e përpunimit aktiv.**

6.2. Të gjitha veprimtaritë e Shoqërisë regjistrohen në Qendrën Kombëtare të Biznesit.

6.3. Për kryerjen e aktivitetit të sipërpërmendur, në rast se do të nevojiten autorizime përkatëse, shoqëria është e detyruar të pajset paraprakisht me këto autorizime nga organi/institucioni kompetent.

## **KREU II KAPITALI**

#### Neni 11

#### **Kapitali themeltar**

11.1. Kapitali themeltar i Shoqërisë është 100.000 (njëqind mijë) Lekë.

11.2. Ky kapital është tërësisht i nënshkruar dhe i shlyer nga ortaku i vetëm. Pjesëmarrja e themeluesve në kapitalin e shoqërisë është në përputhje me kontributet e tyre të mëposhtme:

*Senylo B...*  
*B...*



- a) **Ortaku themelues, Z. Serxho Braçe**, i cili zotëron 100% të numrit total të kuotave, të barabartë me një kuotë.



**11.3.** Kontributi i ortakëve mund të jetë në para ose në natyrë (pásuri të luajtshme/të paluajtshme apo të drejta).

#### Neni 12

### Zmadhimi dhe zvogëlimi i kapitalit

**12.1.** Shoqëria mund të shtojë ose zvogëlojë kapitalin, në varësi të nevojave dhe rezultateve të saj, sipas vendimit të ortakut të vetëm dhe sipas mënyrave dhe rregullave të Ligjit nr. 9901, datë 14.04.2008 "Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare", i ndryshuar.

#### Neni 13

### Transferimi i kapitalit

**13.1.** Kuotat e kapitalit të Shoqërisë e të drejtat që rrjedhin prej tyre mund të fitohen apo kalohen nëpërmjet:

- kontributit në kapitalin e Shoqërisë;
- shitblerjes;
- trashëgimisë;
- dhurimit;
- çdo mënyre tjetër të parashikuar me ligj.

Pjesët e kapitalit themeltar janë lirisht të transferueshme në rrugë trashëgimie.

## KREU IV

## ORGANET VENDIMMARRËSE DHE DREJTUESE

#### Neni 14

### Organi vendimmarrës

**14.1.** Asambleja e Ortakut të Vetëm është organi i vetëm vendimmarrës i Shoqërisë.

**14.2.** Asambleja e Ortakut të Vetëm është organi i vetëm vendimmarrës i Shoqërisë që miraton çdo ndryshim të statutit sipas modaliteteve të përcaktuara në ligj.

**14.3.** Asambleja e Ortakut të Vetëm është përgjegjëse për marrjen e vendimeve për Shoqërinë për çështjen e mëposhtme:

- përcaktimin e politikave tregtare të shoqërisë;
- ndryshimet e statutit;
- emërimin dhe shkarkimin e administratorëve;
- emërimin dhe shkarkimin e likujduesve dhe ekspertëve kontabël të autorizuar;
- përcaktimin e shpërblimeve për personat e përmendur në shkronjat c) dhe ç) të kësaj pike;
- mbikëqyrjen e zbatimit të politikave tregtare nga administratorët, përfshirë përgatitjen e pasqyrave financiare vjetore dhe të raporteve të ecurisë së veprimtarisë;
- miratimin e pasqyrave financiare vjetore dhe të raporteve të ecurisë së veprimtarisë;

*Serxho Braçe*  
*BBraçe*



- h) zmadhimin dhe zvogëlimin e kapitalit;
- i) pjesëtimin e kuotave dhe anulimin e tyre;
- j) përfaqësimin e Shoqërisë në gjykatë dhe në procedimet e tjera ndaj administratorëve;
- k) riorganizimin dhe prishjen e shoqërisë;
- l) miratimin e rregullave procedurale të mbledhjeve të asamblesë;
- m) çështje të tjera të parashikuara nga ligji apo statuti.

Çdo ndryshim statuti duhet të depozitohet pranë QKB për të pasqyruar ndryshimet në skedën e shoqërisë.

### Neni 15 Administrimi

**15.1.** Asambleja e Përgjithshme emëron një ose më shumë persona fizikë si administratorë të shoqërisë. Afati i emërimit është 5 (pesë) vjet, me të drejtë ripërtëritje. Emërimi i administratorëve prodhon efekte pas regjistrimit në Qendrën Kombëtare të Biznesit

**15.2.** Personat e mëposhtëm caktohen si Administratorë të shoqërisë, deri në emërimin tjetër:

Të dhënat e identifikimit:  
(mbiemri, emri, adresa):  
- Braçe, Serxho, Tiranë

dhe specimenët e nënshkrimit:

*Serxho Braçe*  
*SBraçe*

### Neni 15 Kompetencat e Administratorëve

Administratorët kanë të drejtë e detyrohen të:

- (a) kryejnë të gjitha veprimet e administrimit të veprimtarisë tregtare të shoqërisë, duke zbatuar politikat tregtare, të vendosura nga asambleja e përgjithshme;
- (b) përfaqësojnë shoqërinë;
- (c) kujdesen për mbajtjen e saktë e të rregullt të dokumentacionit dhe të librave kontabël të shoqërisë;
- (d) përgatisin dhe shkruajnë bilancin vjetor, bilancin e konsoliduar dhe raportin e ecurië së veprimarisë dhe, së bashku më propozimet për shpërndarjen e fitimeve, i paraqesin këro dokumente përpara asamblesë së përgjithshme për miratim;
- (e) krijojnë një sistem paralajmërimi në kohën e duhur për rrethanat, që kërcënojnë mbarëvajtjen e veprimtarisë dhe egzistencën e shoqërisë;
- (f) kryejnë regjistrimet dhe dërgojnë të dhënat e detyrueshme të shoqërisë, siç parashikohet në ligjin për Qendrën Kombëtare të Biznesit;
- (g) raportojnë përpara Asamblesë së Përgjithshme në lidhje me zbatimin e politikave tregtare dhe me realizimin e verpimeve të posaçme me rëndësi të veçantë për veprimtarinë e shoqërisë;
- (h) kryejnë detyra të tjera të përcaktuara në ligj dhe statut.

### Neni 16 Përgjegjësitë e Administratorit

**16.1.** Administratori është përgjegjës individualisht ndaj shoqërisë ose ndaj të tretëve, për shkelje të ligjeve, për shkelje të statutit, apo për faje të kryera gjatë administrimit të shoqërisë.

*Serxho Braçe*  
*SBraçe*





**16.2.** Pasojat e marrëveshjeve të pamiratuara nga asambleja që i sjellindëm shoqërisë, i ngarkohen administratorit dhe ortakut që ka bërë marrëveshjen, për të përballuar në mënyrë individuale ose solidarisht sipas rastit pasojat përkatëse.

**16.3.** Përveç sa është parashikuar në dispozitat e përgjithshme të detyrimit të besnikërisë, sipas neneve 14, 15, 17 dhe 18 të ligjit "Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare", Administratori detyrohet:

- a) të kryejë detyrat e tij të përcaktuara në ligj dhe në statut në mirëbesim e në interesin më të mirë të shoqërisë në tërësi, duke i kushtuar vëmendje të veçantë ndikimit të veprimtarisë së shoqërisë në mjedi;
- b) të ushtrojë kompetencat që i njihen në ligj dhe në statut vetëm për arritjen e qëllimeve të përcaktuara në këto dispozita;
- c) të vlerësojë me përgjegjësi çështjet, për të cilat merrret vendimi;
- d) të parandalojë dhe mënjanojë rastet e konfliktit, prezent apo të mundshëm, të interesave personale me ata të shoqërisë;
- e) të ushtrojë detyrat e tij me profesionalizëm dhe kujdesin e nevojshëm.

## **KREU IV VITI FINANCIAR - EKSPERTËT**

### **Neni 17 Viti financiar**

Viti financiar i Shoqërisë fillon me datë 1 (një) Janar dhe përfundon me datë 31 (tridhjetë e një) Dhjetor.

### **Neni 18 Ekspertët**

**18.1.** Eksperti ka për detyrë që të kontrollojë të gjithë dokumentacionin kontabël të veprimtarisë ekonomiko tregtare të shoqërisë, atë gjithëvjetor dhe atë në lidhje me kontrollet periodike të ushtruara prej tij për rastet kur ai është ngarkuar dhe ka kryer një gjë të tillë i ngarkuar nga ana e ortakëve.

**18.2.** Në përfundim të kontrollit, eksperti kontabël i autorizuar përgatit raportin me shkrim për nxjerrjen e rezultatit financiar vjetor si dhe për atë për kontrollet periodike të ushtruara, të cilat është i detyruar që t'ia paraqesë e dorëzojë në kohë ortakëve për t'i shqyrtuar e miratuar mbi bazën e të drejtës vendimore që ka.

### **Neni 19 Prishja dhe likujdimi**

Shpërndarja ose prishja e shoqërisë mund të bëhet në çdo kohë:

- a) me vendim të Asamblesë së Ortakëve;
- b) me hapjen e procedurave të falimentimit;

*Senjo Braco*  
*SR*

c) nëse nuk ka kryer veprimtari tregtare për dy vjet dhe nuk është njoftuar pezullimi i veprimtarisë në përputhje me ligjin për Qendrën Kombëtare të Biznesit.

d) me vendim të gjykatës;

Në këtë rast Ortakët marrin vendim me shkrim në të cilin përcaktojnë mënyrën e likuidimit të shoqërisë, duke caktuar 1 (një) ose më shumë likuidatorë dhe shënuar në çdo dokument të nxjerrë prej tij emrin e likuidatrit dhe emertesën shtesë "Shoqëri në likuidim e sipër".

Prishja e shoqërive tregtare ka si pasojë hapjen e procedurave të likuidimit në gjendjen e aftësisë paguese, me përjashtim të rasteve kur është nisur një procedurë falimentimi. Likuidimi kryhet nga likuiduesit e emëruar nga Ortakët.

#### Neni 20

### **Riorganizimi i shoqërisë dhe bashkimi-ndarja**

Shoqëria mund të ndahet, bashkohet sipas Vendimit të Mbledhjes së Përgjithshme të Asamblesë së Ortakëve, në përputhje me dispozitat ligjore të parashikuara në Ligjin për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare".

#### Neni 21

### **Mosmarrëveshjet**

Për mosmarrëveshjet që mund të lindin në lidhje me zbatimin apo interpretimin e këtij statuti, si dhe për çdo mosmarrëveshje që mund të lindë midis Shoqërisë dhe të tretëve, do të jetë kompetente Gjykata Shqiptare.

### **ORTAKU I VETËM I SHOQËRISË ME PËRGJEGJËSI TË KUFIZUAR "SERREZ"**

**Serxho Braçe**

*Serxho Braçe*  
*Serxho Braçe*

---